

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.Sh.nga fshati D. e U., KK. P., M.Z.dhe S.S. që të dy nga Podujeva, rr. “...” pn., për shkak të veprave penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 e KPK-së, Dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale nga neni 305 par.1 të KPK-së dhe Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së, sipas Aktakuzës së PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.802-3/2007 dt.06.01.2010, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 02.10.2014 dhe 14.10.2014, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Ibrahim Berisha dhe të akuzuarit A.Sh., me datë 14.10.2014 mori dhe publikisht shpalli këtë aktgjykim, i cili u përpilua me datë 24.10.2014 :

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari:

I. **A. SH.**, i biri i E. dhe R., e vajzërisë B., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin D. e P., KK P., ku edhe tani jeton, me numër personal: *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë ka qenë i gjykuar për vepra të njëjta dhe ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera penale, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### Sepse:

Me dashje që vetes t’i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, me datën 08.02.2007, rreth orës 22:00, në fshatin D. KK P., me përdorimin e forcës dhe me mjete të përshtatshme-shufër metalike së pari ka kaluar murin me një lartësi prej 2.20cm dhe ka shkuar afër shtëpisë dhe me këtë shufër ka thyer xhamin e dritares së kulmit përmes të cilës ka depërtuar brenda në shtëpi, duke hyrë në katin e parë dhe të dytin dhe në katin e parë në kuzhinë ka vjedhur këto sende: një televizor i tipit “Filips”, një korrektor ngjyrë e bardhë, një aparat të kafesë ngjyrë të bardhë e tipit “Kropus”, dy nxemje, një kasetofon me ngjyrë të zezë, ndërsa në katin e dytë ka marrur një thithëse elektrike, një nxehtëse me tre tela ngjyrë hiri, kasetofon “MP3” me CD, ngjyrë të zezë, të gjitha këto sende i ka qitur përmes dritares së katit të parë afër derës kryesore të hyrjes, të cilat i ka dërguar deri afër

rrugës së asfaltuar në një fushë të cilat i ka mbuluar që mos të shihen, pronë e të dëmtuarit F.Sh., me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.-

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së,

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,11,15,34,36,38,64, dhe në bazë të nenit 253 par.1 pika 1 e KPK-së, si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, e

## G J Y K O N

Të akuzuarin A. (E.) Sh., me dënim me burg, ashtu që i shqipton **dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve**, të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve paushalle të paguajë shumën prej **50€** (pesëdhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa shpenzimet e procedurës penale nuk janë shkaktuar.

I dëmtuari F. (H.) Sh. nga fshati D. e U., KK. P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

### **Ndërsa ndaj të akuzuarve:**

**II. M. Z.**, me pseudonimin (T.), i biri i M. dhe nënës B., e vajzërisë R., i lindur më datë *data e lindjes...*, në P., rr. "...” pn, i pa martuar, ka të kryer gjashtë klasë të shkollës fillore, din shkrim –lexim, me profesion elektrikist, më parë i padënuar, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**III.S. S.**, i biri i O. dhe M., e gjinisë Sh., i lindur me *data e lindjes...*, në P., rr. "D.” pn., i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, din shkrim-lexim, me profesion ndërtimtar, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i padënuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,

## **REFUZOHET AKUZA**

Sepse:

1. Me datën 08.02.2007, rreth orës 24:00, në fshatin D. e P., KK. P., me dashje që ti jep ndihmë kryesit të veprës penale të pandehurit A. Sh., ku i pandehuri A. ka shkuar së pari te S. për ta thirrur dhe së bashku me të pandehurin S. kanë shkuar te M. të cilëve iu ka treguar se i ka vjedhur disa sende në një shtëpi në fshatin D. dhe ato sende i ka fshehur në

një fushë afër rrugës së asfaltuar ku M. ka marrur veturën e babait të tij të tipit “Golf 2” me ngjyrë të kuqe, kanë shkuar së bashku që të tre, ku i kanë ngarkuar me në veturë dhe i kanë dërguar një pjesë në shtëpinë e të pandehurit M. dhe një pjesë të sendeve i kanë fshehur te shtëpia e S., ku të pandehurit i kanë dhënë ndihmë dhe strehim me qëllim të fshehjes së provave të kryerjes së veprën penale, në shtëpinë e vjetër të pa banuar të pandehurit S. i janë gjetur tri nxemse elektrike, një fshesë elektrike dhe një kasetofon,-

- me këtë secili veç e veç kishin për të kryer veprën penale Dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale nga neni 305 par.1 të KPK-së.

2. Me datën 08.02.2007, pas orës 24:00 në fshatin D. e p., Komuna P., gjatë rrugës për tu kthyer nga vendi i kryerjes së veprës penale edhe pse e kanë ditur se sendet janë përfituar përmes kryerjes së veprës penale, i pandehuri M.Z. ka blerë nga i dyshuari A.: televizorin, korrektorin e rrymës, një kasetofon, që të gjitha në vlerë prej 20 €; ndërsa i pandehuri S.S. ka blerë nga i pandehuri A.: një resiver, një uji për hekurosje, një aparat elektrik për përgatitjen e kafes, të gjitha këto në vlerë prej 15 €.-

- me këtë secili veç e veç kishin për të kryer veprën penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së.

Sepse gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këto vepra penale me datën 08.02.2011.

Shpenzimet e procedurës penale sa i përket të akuzuarve M.Z. dhe S. S., bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

### **A r s y e t i m**

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën, PP.nr.802-3/2007 të dt.06.01.2010, kundër të akuzuarve: A.Sh. nga fshati D. e U., KK. P. për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 e KPK-së, M.Z. dhe S.S. që të dy nga P., rr. “...” pn., për shkak të veprave penale Dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale nga neni 305 par.1 të KPK-së dhe Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 02.10.2014, në të cilën prezantoi vetëm përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë Bukurije Gjonbalaj, ndërsa palët tjera nuk prezantuan edhe pse ishin ftuar në mënyrë të rregullt. Në këtë seancë gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstatoi se lidhur me të pandehurit M.Z. dhe S.S. ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për veprat penale për të cilat akuzohen, andaj morri aktvendim për hedhjen e aktakuzës së PPK në Prishtinë – tani Prokuroria Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.802-3/07 të dt.06.01.2010, për të pandehurit M. (M.) Z. dhe S. (I.) S. dhe pushimin e procedurës penale për shkak të parashkrimit absolut të veprave penale Dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale nga neni 305 par.1 të KPK-së dhe Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së, në kuptim të nenit 90 par.1 nën par.6 dhe nenit 91 par.6 të KPK-së, ndërsa procedurën penale e vazhdoi vetëm sa i përket të pandehurit A.Sh. sipas aktakuzës së PPK në

Prishtinë tani Prokuroria Themelore Prishtinë PP.nr.802-3/07 dt.06.01.2010, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së.

Lidhur me çështjen penale kundër të akuzuarit A. Sh., gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datën 14.12.2014, gjatë së cilës u dëgjuan përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe i akuzuari.

Prokurori shtetit Ibrahim Berisha në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë së të pandehurit, pasi që është bërë konform dispozitave ligjore dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranon në tërësi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, se e ndjen veten fajtorë, pendohet për veprën e kryer dhe i premtan gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 e KPK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata të dëmtuarin F.Sh., për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti vetëm faktin se i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar e pranoi fajësinë, duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata mori parasysh se i njëjti edhe më parë është gjykuar për vepra penale të vjedhjes së rëndë dhe se ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera penale për vepra të njëjta, e po ashtu mënyra dhe koha e kryerjes së veprës penale është shqetsuese, ngase është krijuar një pasiguri e madhe e shoqëris në Kosovë, se ky lloj i veprave penale është bërë dukuri e shpeshtë në vendin tonë, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, dënim ky të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

konsideroi se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmëris shoqërore si dhe përgjegjësisë penale dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij dhe si masë parandaluese me efekt në persona të tjerë për moskryerjen e veprave penale të parapara sipas dispozitës së nenit 34 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin A.Sh. është marrë në kuptim të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale sa i përket të akuzuarve M.Z. dhe S. S., është marrë në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 dhe 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**  
**PKa.nr.4/2010 dt.24.10.2014**

**Sekretare juridike,**  
Mihrie Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.